

## PEGINPOL MACROGOL 3350



### PEGInpol Macrocol 3350 Pluhur për suspension oral

#### **Përdoret për trajtimin e konstipacionit**

##### **Përbërësit:**

100 g Macrocol 3350, dioksid Silici, aroma, saccharin sodium.

**Sasia** :100 g

**Nuk përmban gluten dhe laktozë.**

##### **Indikohet:**

PEGInpol është një preparat mjekësor i papërgatitur në formë pluhuri i përdorshëm në trajtimin e konstipacionit .

PEGInpol është vecanërisht i indikuar në konstipacionin kronik dhe në rastet e crregullimeve intestinale të herë pas hershme.

##### **Përdorimi :**

- Nga 6 muaj deri 2 vjec (deri në 12 kg): 0,8 g për kg peshë trupore në ditë.
- Nga 2 vjec deri në 11 vjec (nga 12 kg deri 20 kg): 1 g për kg peshë trupore në ditë.
- Mbi 11 vjec (më shumë se 20 kg): 10-30 g në ditë(5-15 lugë ).

Doza mund të rritet ose të ulet në varësi së përgjigjes individuale nga trajtimi

Doza më e saktë e përditshme sipas grupmoshave mund të vendoset në bazë të peshës së fëmijës dhe në bazë të shkallës së konstipacionit.

Është e këshillueshme që në cdo rast të dëgjohet mendimi i mjekut për dozën e saktë..

Përdorëni produktin në moshat pediatrike vetëm mbas këshillimit të mjekut.

Doza maksimale e nevojshme normalisht nuk kalon 30 g të produktit në ditë.

Sipas posologjisë së treguar më sipër, merreni sasinë e produktit me ndihmën e luges matëse së pajisur me pika të cilat lejojnë dozimin e produktit .

Pluhuri shkrihet në ujë, për cdo lugë (e barabartë me 2 g) nevojitet rreth ¼ e gotës me ujë (rreth 25 ml).

Ju mund ta ndani dozën e përditshme në disa doza .

Është e këshillueshme të pihet PEGInpol në mes të ngrënies.

##### **Karakteristikat :**

PEGInpol është një preparat mjekësor me veprim laksativ , nëpërmjet një mekanizmi të tipit osmotik, rregullon intestinën në mënyrë natyrale.

PEGInpol është vecanërisht i indikuar në konstipacionin kronik dhe në rastet e crregullimeve intestinale të herë pas hershme.

Falë lidhshmërisë me ujin, PEGInpol zbut fecet duke lehtësuar jashtëqitjen pa shkaktuar dhimbje abdominale.

Efikasiteti i tij nuk reduktohet me kohën.

***Nuk përthithet, as fermentohet në intestin, nuk irriton mukozën dhe eliminohet me fecet.***

**Kujdes !**

- Suspensioni oral duhet të përgatitet në kohën që do të pihet.
- Këshillohet mos të konsumohen sasi më të mëdha sesa ato të dhëna, sepse sasi më të mëdha mund të shkaktojnë efekte anësore të papritura
- Për periudhë përdorimi më të gjatë se 30 ditë është e rekomandueshme të ndërpritet trajtimi me PEGInpol së paku 3-5 ditë.
- Mos e merrni në rastin e intolerancës ndaj produktit.
- Mos e merrni në rast të mbindjeshmërisë ndaj komponentëve dhe Polietileni Glycol.
- Mos e përdorni te fëmijët më pak se 6 muajsh.
- Gjatë trajtimit me PEGInpol është e këshillueshme ndjekja e një diete të përshtatshme të shoqëruar me një solucion oral hidratues për të parandaluar dehidrimin, gjithsesi këshillohet konsultimi me mjekun.

**Paketimi :** Shishe 100 gr me lugë të milimetruar 0,5g(niveli i parë ) 1g (niveli i dytë) 2g(masë luge)